



## Përshkrimi i punës - Dekani, Fakulteti i X

Universiteti i Prishtinës, universiteti më i madh publik i Kosovës, është i angazhuar për edukimin e studentëve, kryerjen e hulumtimeve, botimin e hulumtimeve në revistat më të mira dhe prezantimin në konferencat kryesore udhëheqëse në botë. Dekanët e UP-së janë përgjegjës për menaxhimin e fakulteteve që prodhojnë, masin dhe publikojnë rezultatet të cilat demonstrojnë avancimin e UP-së si një institucion si dhe angazhimin e vet fakultetit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkime. Dekanët kanë përgjegjësi ekzekutive për menaxhimin e burimeve të fakultetit të tyre, duke përfshirë shërbimet fiskale, objektet dhe njerëzit. Ata janë përgjegjës për të udhëhequr proceset e planifikimit duke siguruar përputhjen e planeve të fakultetit për veprimtari arsimore, kërkimore dhe të tjera me Planin Strategjik të UP-së.

Si drejtor ekzekutiv i njësisë akademike, me përgjegjësi të gjerë për rezultatet në mësimdhënie, kërkime, shërbime studentore, menaxhim dhe buxhet, Dekani drejtpërdrejt mbështet dhe kontribuon në vizionin strategjik të Rektoratit. Ai / ajo bashkëpunon me Zëvendës Rektorët për Mësimdhënie, Kërkime, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Financa dhe Sigurim të Cilësisë, duke mbështetur përpjekjet e tyre për të përmirësuar performancën dhe reputacionin e UP-së. Dekani i raporton Rektorit të Universitetit.

### **Lidershipi**

1. Kultivon një mjedis kolegjal, bashkëpunues dhe studimi që i shërben interesave të përbashkëta të studentëve, profesorëve, stafit menaxherial dhe administrativ.
2. Drejton dhe bashkërendon punën e të gjithë stafit akademik dhe joakademik në fakultet.
3. Demonstron lidershipin e karakterizuar nga transparenca dhe integriteti profesional, duke frymëzuar kështu bashkëpunimin, inovacionin dhe respektin e ndërsjellë në mes të mësimdhënësve dhe personelit administrativ dhe studentëve.

4. Komunikon profesionalisht - me shkrim dhe me gojë - për të siguruar që të gjitha shqetësimet, prioritetet strategjike dhe arsimore dhe çështjet e tjera të të gjitha departamenteve akademike dhe njërive administrative të Fakultetit janë kuptuar plotësisht brenda fakultetit dhe Rektoratit.

5. Duke qenë shembull, Dekani faciliton gjetjen e zgjidhjeve produktive dhe të drejta të konflikteve brenda fakultetit.

## **Administrata**

1. Është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgatitjes dhe administrimit të buxhetit të fakultetit.
2. Mbështet të gjitha departamentet akademike në fakultet dhe koordinon së bashku me Zëvendës Rektorin për mësimdhënie zhvillimin dhe zbatimin e qëllimeve të planifikimit strategjik në përputhje me planin strategjik të UP-së.
3. Mbështet dhe mbikëqyrë të gjitha departamentet akademike, duke siguruar që ata të përmbushin qëllimet e fakultetit dhe administratën qendrore të UP-së në lidhje me regjistrimin, mbajtjen dhe diplomimin e studentëve
4. Merr pjesë në vendimet e vlerësimit të fakultetit, në përputhje me statutin e UP-së dhe Ligjin e Arsimit të Lartë të Kosovës.
5. Mbikëqyr dhe shqyrton të gjitha programet akademike në fakultet.
6. Mbështet dhe mbikëqyrë të gjitha departamentet akademike, në bashkëpunim me Zëvendës Rektorët për Mësimdhënien dhe Sigurimin e Cilësisë, për të krijuar sisteme për vlerësimin e lëndës, programit dhe fakultetit.
  - a. Siguron përdorimin e praktikave më të mira për vlerësimin e rezultateve të të nxënit të studentëve;
  - b. Koordinon mësimdhënësit e fakultetit të përdorin rezultatet e procesit të vlerësimit për përmirësimin e programeve në fakultet
7. Mbështet të gjitha departamentet akademike dhe Zëvendës Rektorin për Mësimdhënie për të zhvilluar dhe rishikuar programet ekzistuese akademike në fakultet.
8. Punon me zyrat dhe stafin e duhur për të plotësuar nevojat e studentëve dhe stafit për burimet teknologjike për mësimdhënie dhe mësim si dhe për kërkime dhe bursa
9. Siguron që të gjitha departamentet akademike të mirëmbajnë proceset e tyre të akreditimit dhe ri-akreditimit për agjencitë e duhura në Kosovë dhe në nivel ndërkombëtar.

## **Vizioni**

1. Mbështet dhe realizon angazhimin e UP-së për vlerat dhe misionin e tij, nxitjen e diversitetit dhe përfshirjes, mbështetjen e zhvillimit të të gjithë personave dhe promovimin e integritetit dhe drejtësisë në të gjitha çështjet.
2. Zhvillon iniciativa dhe programe akademike që tërheqin dhe mbajnë studentët dhe stafin mësimdhënës më të mirë të Kosovës;
3. Zhvillon dhe komunikon Vizionin e UP-së për përsosjen e mësimdhënies, duke zhvilluar një reputacion për leadership në pedagogji dhe bursa.
4. Promovon programe akademike që rrisin maksimalisht kontributet e UP-së në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

## **Përfaqësimi**

1. Përfaqëson interesat e stafit, studentëve dhe programeve akademike të fakultetit.
2. Përfaqëson fakultetin në mjediset përkatëse të qeverisjes dhe komitetet e universitetit.
3. Merr pjesë në informimin e komunitetit dhe përfaqëson shkollën dhe universitetin në organizatat kombëtare, rajonale dhe shtetërore

## **Akademike / Shkencore**

1. Mbështet dhe monitoron përpjekjet për të sjellë fonde për mësimdhënie dhe kërkime pedagogjike.
2. Mbështet dhe kërkon fonde për punën hulumtuese dhe akademike të fakultetit dhe studentëve në fakultet

## **Karakteristikat e dëshiruara**

- Kuriozitet intelektual nëpër disiplina
- Integritet i lartë
- Energji e lartë
- Altruizëm
- Respekt për kolegë
- Karizmatik, me aftësi për të përfaqësuar më të mirën e UP-së
- I vendosur

## Treguesit kryesorë të performancës / Synimet



### KORNIZA E LIDERSHIPIT PËR DEKANËT

Dimensioni	Indikatorët	Nën pritshmëritë	Sipas pritshmërisë	Mbi pritshmëritë
<b>Lidershipi</b>	Komunikon qëllimet, objektivat, planet e punës, dhe synimet, plotësisht dhe qartë Inspiron studentët dhe stafin Ndërton dhe mbështetë programe inovative Zhvillon partneritete të dobishme			
<b>Menaxhimi i resurseve</b>	Udhëheqë procesin efektiv dhe gjithëpërfshirës buxhetor për fakultetin Siguron që objektet, klasat, bibliotekat, revistat dhe nevojat e IT-së janë plotësuar. Menaxhon buxhetin dhe burimet e fakultetit në mënyrë efektive Zhvillon programe për të tërhequr fonde nga burime të jashtme Plotëson të gjitha kërkesat e raportimit të Institucioneve qeveritare të Kosovës dhe UP			
<b>Planifikimi strategjik</b>	Ndërton strategjinë e fakultetit rreth Planit Strategjik të UP-së (PS) Kupton, komunikon dhe punon që stafi i fakultetit të arrin përgjegjësitë e PS Plotëson të gjitha kërkesat e UP për raportimin e të dhënave në kohë Përcjellë progresin e stafit të fakultetit dhe iu komunikon Mban stafin përgjegjës për përmbushjen e objektivave.			
<b>Sigurimi i cilësisë</b>	I komunikon stafit akademik indikatorët matës për sigurimin e cilësisë të Rektoratit Zhvillon indikatorë matës shtesë për sigurimin e cilësisë së bashku me mesimdhënës dhe stafin Mat performancën dhe raporton rezultatet brenda dhe jashtë Demonstron përmirësimin e aftësisë dhe performancës individuale dhe të stafit akademik Të gjitha kurset e studimeve themelore universitare përdorin faqet e kurseve, Moodle, ose Sist Zhvillon, publikon dhe përmbushë afatet kohore për regjistrimin e studentëve dhe raportin sta			
<b>Kërkimet/Hulumtimet</b>	Punon me stafin akademik për të zhvilluar planin dhe synimet e hulumtimit 50% e Profesorëve paraqesin të paktën një propozim për grant, çdo vit. Stafi akademik paraqet 3-5 propozime kërkimore për Horizon 2020, në vit 100% e propozimeve të hulumtimeve të stafit akademik dorëzohen përmes ZKPS-së së UP-së 10% rritje vjetore në botimet e stafit akademik në revistat kryesore 25% e profesoriatit të fakultetit marrin pjesë në të paktën një konferencë vjetore, relevante, nd			
<b>Mësimdhënia</b>	Zhvillon sistemin e sigurisë për matjet e të nxëniet Përfshin pikëpamjet e studentëve dhe stafit në vlerësimin e cilësisë Siguron që të gjitha kurset e studimeve themelore janë në një Sistem Elektronik të Menaxhimit			
<b>Zhvillimi i kuadrit</b>	Çdo anëtar i stafit ka një përshkrim të qartë dhe të përditësuar të detyrave të punës me tregues Fakulteti ofron mundësi trajnimi për stafin për të zhvilluar aftësi për të përmbushur pritjet Çdo anëtar i stafit merr vlerësim gjysmëvjetor dhe vjetor me shkrim dhe me gojë nga mbikëqyr Fakulteti ofron mundësi trajnimi për stafin për të zhvilluar aftësi për të përmbushur pritjet			
<b>Akreditimi</b>	Dekani siguron akreditimin dhe ri-akreditimin e programeve Stafi i fakultetit i përgjigjet kërkesave të akredituesit në mënyrë të plotë dhe sipas afateve Dekani siguron që Drejtuesit e Departamentit të ju përgjigjen të gjitha kërkesave të akreditimit			
<b>Përfaqësimi</b>	Fakulteti gjeneron së paku një storie pozitive në media në çdo dy muaj. Përfaqësimi i Dekanit të UP-së në media është në përputhje me standardet e komunikimit publ Të gjitha komunikimet e fakultetit përputhen me standardet e UP-së			